



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republike of Kosovo



Komuna e Gjiçanit  
Opština Gjiçane  
Municipal Gjiçan  
Gilan Belediyesi

---

**Drejtoria për Rini, Kulturë e Sport**  
**Uprava za Omladinu Kulturu i Sport**  
**Gençlik Sporve Kultur Mudurlugu**

**Për : Kryetarin e Komunës z. Qemajl Mustafa**  
**Bordin e Drejtorëve**  
**Nga ; Drejtori për Rini, Kulturë e Sport z. Selver Xhelili**  
**Qëllimi : Raprti gjashtëmuor 2010**

Nga fillimi i punës në Drejtorin përkatëse kryesisht kam zhvilluar takime me stafin e Drejtorisë , si dhe me menaxhmentin e Teatrit dhe të Bibliotekës për tu njohur me fushëveprimtarin e tyre .

Fillimisht kam përgatitur vendimin për respektimin e kodit të mirësjelljes dhe respektimit të orarit të punës që pastaj ju është shpërndarë të gjithë personelit në kuadër të drejtorisë sonë.

Gjate takimeve me menaxhmentin e teatrit kemi diskutuar probleme të shumta që janë grumbulluar në këto institucione dhe mundësitë e zgjidhjes së tyre .

### **Spektori i rinisë**

Në fillim të periudhës vjetore 2010 është punuar në promovimin e programit për rininë i prezentuar si programi në bashkëpunim me Forum Syd – Suedi dhe njëkohësisht janë paraqitur edhe nevojat e sektorit të rinisë nga ana e zyrtarit për rininë.

Programi ka të bëjë kryesisht me “Community Youth Work in Kosovo” dhe i dedikohet grupit moshës mbi 18 vjeçar e deri në moshën 45 vjeçare që kryesisht do të kenë mundësi për të aplikuar në këto programe dhe për të fituar njohuritë dhe domosdoshmëritë të punës me komunitetin rinor.

Takimet me Drejtorin e bibliotekës për të koordinuar punët dhe angazhimet e përbashkëta në drejtorinë për mirëvajtjen e punëve dhe në këto institucione.

Gjithashtu në kemi bashkëpunuar ngushtë edhe me Qendren rajonale të Trashëgimisë Kulturore dhe me drejtorinë e Inspeksionit dhe të Urbanizmit , për projektin e fillimit të punimeve në ndërtimin e Sahat Kullës.

Në bashkë me zyrtarin e rinisë kemi zhvilluar një takim pune me përfaqësuesit e Ministrisë së Kulturës, Rinisë e Sporteve dhe të organizatës qeveritare Gjermane GTZ-së në Prishtinë për qeshtjet e mbështetjes dhe përkrahjes së strukturave rinore në Komunën e Gjiçanit dhe në këto takime kanë marrë pjesë dhe sektoret rinore të të gjitha komunave të

Kosoves , ku ka rrjedhe inisiativa per krijimin e asociacionit te zyrtareve rinore te komunave te Kosoves.

Nga ky takim kemi marre ftesen qe te mbahet takimi me Drejtoret e Drejtorive Komunale për Kulturë, Rini e Sporte prt te fuqizuar rolin e komunave ne implementimine programeve per rini..

Gjithashtu së bashku me sektorin e rinise kemi zhvilluar nje takim me Organizaten “SISU” nga Suedia e cila do te zhvilloj nje program mbeshtetje te sporteve ne komunen tone duke organizuar trajnime ,seminare dhe ligjerate per klubet e sportit ne komune tone dhe te rinjet.

Më dat 22 dhe 23 maj 2010 kemi marrë pjesë në Festivalin e Instrumentistëve të rinjë në Fushe Arrez në perfaqesim të komunes sone nga ana e Drejtorit për Rini , Kulturë e Sporte ne shoqerim nga zyrtari i Rinisë , duke zhvilluar kontakte me shume perfaqesues nga Komunat pjesemarrrese nga troje te ndryshme mbarekombetare.

Grupi i të rinjëve nga Ansambli Gurra ke performuar me kater pika ne kete festival duke prezentuar kryesishte vlerat e treves se Gjilanit .

Ne kete festival kan marre pjese keto komuna: **Mati, Lushnja , Hasi, Ohri, Drenasi, Vau Dejes, Gramshi, Tropoja, Puka, Gjilani, Dibra ,Zhuri, Permeti, Miredita, Lipjani, Fushe Arrezi.**

Pjesemarrja jonë ne kete festival na ka mundesura takime me perfaqesues dhe pjesemarrez nga te gjitha grupet dhe komunat si dhe bashkebisedime me organizatorin e festivalit.

Kryesishte kemi vendosur bashkepunim dhe kontakte te mira me Kumunen Fushe Arrez, gjegjesishte me drejtorin Mirash Mardodaj, pastaj me Drejtorin e komunes se Miredites z. Kolë Gjikoleun si dhe me Drejtorin e Peshkopisë z. Ismet Spahiu dhe me Drejtoreshen e Qendres se te rinjeve dhe femijeve znj.Moza Bulku.

**Ne funde te ketij festivali jemi nderuar me nje Qertifikate mirenjohese per pjesemarrjen e denje te komunes sone ne kete festival.**

- Ne bashkepunim me organizaten” rinia pa kufi” dhe ne partneritet me Policin e Kosoves eshte zhvilluar aktiviteti “Policia dhe Komuniteti” , ku paraprakishte grupe te te rinjeve jane edukuar per sigurin ne komunitet , dhe kane ber vizita ne qendren e tarjnimeve ne Vushtrri , ndersa me 27. maj kane shfaqur performansen e tyre te gjitha njesitet qe veprojne ne kuader te Policise se Kosoves ne regjionin e Gjilanit. Prezentimi eshte mbajtur ne sallën e teatrit me nje audience te knaqshme dhe shume miqesore ne mes te te rinjeve dhe policise.
- Ne pejesn e dyte te mujait maj kane vazhduar ligjeratat neper shkollat fillore dhe te mesme te komunes sone , ne kuader te fushates vetedijesuese kunder duhanit.
- Kjo fushate e zhvilluar ne bashkepunim te ngushte me institutin e shendetit publik dhe te stafit te qendres se rinise.. Ligjeratat jane zhvilluar ne sh.f. “ Thimi Mitko” dhe sh.f. “Musa Zajmi” me nxenes te klaseve te teta dhe nënta..
- Me date 31.maj ne ditën nderkombetare kunder duhanit jan pergatitur fletepalosje nga institute i shendetit publik dhe jane shperndare qytetareve te dhe te rinjeve ne formen e kembimit te cigareve me peme te ndryshme.

- Bashkepunimi me zyrtaren per te drejta te femijeve per ti ndihmuar ne organizimin e aktiviteve te 1.qershorit dites nderkombetare te te drejtave te femijeve

-Pergatitjet per organizmin e dites se çlirimit te Gjilanit, dhe takimet me ansamblet e qytetit .

Eshte pergatitur nje pytesore profesional për regjenerimin e punësimit për të rinjë ne bashkepunim me organizaten”DANID”-a nga Danimarka , kryesishte është fokusuar ne lemin e e gjetjes se punes per te rinjet e sapodiplomuar ne pergjithesi.

Takimet me grupin e perfaqesuesve te rinje nga organizatat qe jane pjese e keshillit te veprimit rinore ne nivel lokal per mundesite e mbeshtetjes se tyre nga donatore te mundeshem.

Ne kete kuader eshte organizuar takimi me GTZ-në programin EDYK per rini dhe pritet qe te krijohet nje mbeshtetje konkrete per sektorin rinore ne komune.

Bashkarishte me ansamblet e qytetit është pergatitur programi i tyre per te marre pjese ne manifestimin e 15. qershorit.

Në manifestim kan marr pjese Ansambli” Gjilani” , “Gurra”, “Albafolk” , “Bajaram Curri” , “Yarin” dhe ansambli nga Mirëdita.

Nga data 14.qershor 2010 kemi pranuar praktikantet ne kuder te programit per lideret e rinje te mbeshtetur nga USAID-i dhe ne implementim nga Mercy Corps dhe organizata vendore KCIC, e që zhvillohet ne baze te memorandumit te neshkruar nga institucionet gjegjese komunale.

Më dat 16 qershor eshte orgnizuar takimi regjional ne Gjilan me sektoret për rini te komunave Gjilan, Ferizaj, Kamenicë, Kaqanik, Novoberd dhe Viti, si dhe me perfaqesues nga organizatat rinore te regjionit per mundesite e bashkepunimit me implementimin e Ligjit per Fuqizim dhe Pjesemarrje te Rinisë.

- Permes takimeve me grupe te te rinjeve jo formal, ne eshte diskutu prezentimi i planit te veprimit dhe te aktiviteve gjate periudhes gjashtemujore 2010, duke perfshire edhe sfidat dhe mundesite positive gjate realizimit.

Takimi me grupin e te rinjeve prej kater studenteve nga Gjilani qe ju kan mundesuar qe perms DiR te jene fitues te studimeve jashte vendit , dhe ne kete kohe qe ata jane ne pushime verore do ju organizohet nje kamping per te gjithë studentet nga viset e ndryshme te kosoves qe studejojne ne “Y-ve yes program”.

Në kuadër të bashkëpunimit me MKRS- GTZ- së , programit “Fuqizimi i Rinisë në Kosovë” , më 22. qershor është mbajtur takimi i perbashket me temen :

- Gjendja aktuale e sektoreve rinore ne nivel qendror dhe local
- Fuqizimi i bashkëpunimit ndermjet nivelit qendror dhe lokal
- Organizimi i puntorisë(“workshopit”) te perbashket GTZ-MKRS-dhe Grupit Punues nga sektoret Rinore te komunave te regjionit ne Kosove.

Kryesishte janë prezentuar zhvillimet aktuale në të gjitha resoret dhe institucionet rinore , pastaj janë diskutuar hapat e mëtejshëm të implementimit të Ligjit dhe strategjise nacionale për rinë , duke mundësuar organizimin e një konference gjithëpërfshirëse më dat 30 . qershor në Prishtinë për të promovuar dokumentet baze të punës me rinë.

Njëkohësisht është punuar edhe në organizimin e takimit të përbashkët me të gjithë drejtoret e drejtorive komunale për Rinë, Kulturë e Sport me MKRS-në dhe GTZ-në, Takim ky që është mbajtur më dat 23.qershor në Prishtinë

Keshilli i Evropës ka organizuar takim seminarik për qeshtjen e Trashëgimise Kulturore dhe njëkohësisht janë diskutuar edhe mundësitë e zhvillimit të aktiviteteve me të rinjë në ruajtjen e trashëgimise kulturore .

Është shprehur gatishmeria e organizimit të aktiviteteve në formën e vetëdisimit të të rinjëve për rëndësinë e ruajtjes dhe mbrojtjes së trashëgimise kulturore Edhe gjatë kësaj periudhe është mbajtur takimi konsultativ për planin lokal të veprimit për rinë në sinkronizim me strategjinë nacionale të rinisë 2010-2012 të aprovuar nga qeveria e Kosovës.

Programet e sektorit të rinisë janë hartuar në harmoni me rregullativen ligjore dhe strategjinë nacionale për të rinjë 2010-2012, duke krijuar edhe bordin konstituv të keshillit të veprimit rinore lokal.

Prandaj gjatë periudhës së dytë të këtij viti edhe Komuna e Gjilanit do të duhet që përmes përfaqësimit të organizuar të të rinjëve në Organizatat e tyre të krijojë KVRL-në në harmoni me udhëzimet administrative.

### **Spjegim për Keshillin e Veprimit Rinore Lokale:**

Në baze të të gjitha dokumenteve dhe rregullorevë si dhe sipas Ligjit për “Fuqizim dhe Pjesëmarrje të rinisë”, struktura organizative e KVRL-së , është një organ keshilledhënës për të gjitha veprimet dhe vendimet që kanë të bëjnë me qeshtjet e të rinjëve në nivelin lokal dhe nacional.

KVRL-ja do të jetë e përfaqësuar nga të gjitha subjektet rinore në komune dhe organizatat që veprojnë për qeshtje të të rinjëve.

Komuna jone do të duhet që të sigurojë një hapsirë vepruese për udhëheqjen e KVRL-së dhe të sigurojë një subvencion të caktuar vjetorë për funksionimin e KVRL-së

### **Sygjerim:**

Duke pasur parasysh këto zhvillime për perudhën pas raportuesë gjatë gjysmës së dytë të këtij viti, atëherë sygjerohet që të kilet parasysh edhe caktimi i një shume të caktuar subvencionuese për sektorin e rinisë dhe KVRL-në .

### **Spektori i sportit**

Në fillim të vitit u bënë përgatitjet për meremetimin e Stadiumit të Qytetit, I cili deri në atë kohë ishte në gjendje shumë të rëndë.

Drejtorja për RKS , në bashkëpunim me përfaqësuesit e klubeve “KF. Drita dhe KF “Gjilani” u munduam ta kthejmë Stadiumin në gjendje për të qenë e mundur që klubet tona të futbollit të vazhdojnë garat në ligat e Kosovës. Gjendja momentale financiare e klubeve është dukshëm më e mirë se në vitet e kaluara bugjeti I jonë është I limituar dhe nuk mund të plotësoj kërkesat e mëdha që vijnë nga Klubet Gjilanase që janë të regjistruara pranë Drejtorisë sonë dhe bëjnë gara në Superligat e Kosovës. Bashkpunimi me Francën ka vazhduar me ftesën që na I dergoj Z. philipe BEUCHET nga Federata e Volejbollit të Francës

pas marreveshjes se arritur ne strasburg ne mese te Zyrtarit te Sportit dhe Georges MEYER nga Federata regjionale e Volejbollit ne regjionin e Alzasit qe te luhet nji ndeshje miqesore ne mese KV "Drita" Femrat nga Gjilani dhe KV nga MULHOUSE nga Franca ku te gjitha shpenzimet I ka siguruar organizatori pos rruges. Patem ftesen nga Federata e Volejbollit te Frances dhe u bane te gjitha pergatitjet u muaren edhe vizat dhe patem nji perkrahje edhe nga Kryetari I Komunes Federata e Volejbollit te Kosoves Si dhe nga Ministria e sportit te Kosoves por ne momentin e fundit duel pengesa e quajtur Boriqiq Kryetar I Federatese Volejbollit te Serbise dhe Nenkryetar I Konfederates Europiane te Volejbollit ku dhe na I anuloi lojen dhe udhetime u ba I pa mundur me te gjitha perpjekjet qe jane ba edhe nga Ministria e jone e jashtme por edhe nga Ministrijae puneve te jashtme te Frances si dhe nga Ambasadori yne ne Paris Kullashi ku ka nderhy edhe vete presidenti Sarkozy dhe Ministri I jashtem I Frances Z. Kushner. Kjo mos shkuarje e jona pati nji jehone te madhe mediale dhe politike jo vetem ne Kosove por edhe ne France dhe kemi informatat me shkrim se ma nuk do te pengohen asnji e kip Kosovar nga Unioni European .

Gjatë muajit SHKURT – u bënë përgatitjet e shumta, për realizimin e Vrapimit të Qytetit "Gjilani 2010" u ftuan te gjitha shkollat e mesme per te madheshtue kete qerekmarton , u mbajten shumë takime, mbledhje me përfaqësuesit e klubeve, u shqyrtua gjendja momentale e të gjitha klubeve ,dhe mundësija qe klubeve tju krijojmë kushte sa me të mira për fillimin e garave. ekzekutimit të projekteve për këtë vit.

Gjatë muajit MARS- organizuam qerek maratonen pikrisht me daten 14 mars për Senior e Seniore, 4300m. për Junior e Juniore , Veteran e Veterane si dhe në 800m. per Persona me aftësi të kufizuar vrapim me karroca ,në shenjë të nderimit të Pranëverës Studentore të vitit 1981.Në qerek Maratonë patëm atletë dhe atlete nga gjithë Kosova ky manifestim I madhë sportiv u organizua edhe në bashkëpunim me Federaten e Atletikës të Kosoves,në mbarim të këtijë Manifestimi u shperblyen më të mirët me mirënjohje dhe Kupa për atletë dhe atlete në gjitha disiplinat. Ky manifestim për vitin e ardhëshem propozohet të jetë Ndërkombëtar për arsye se është I vetmi këtijë llojit që mbahet me vite në Kosovë dhe këtë e meriton Gjilani.

Gjatë muajit PRILL-.Me 3 prill organizuam Turnirin Memorial Nderkombëtarë në boks"Agim Rashiti" me rastin e 21 vjetorit te renjese se Tij ,nen patronain e Kryetarit te Komunes Z. Qemajl Mustafa.Ne kete turnir muaren pjese Shqiperija,Maqedonia,Qekia,Kosova Lindore dhe Kosova. Ishte nji turnir I organizuar mire sipas normave nderkombetare ku sportistet tane u paraqiten mjaft mire ku Liridon zeqiri u shpall boksieri me I mire I Turnirit Te gjitha ekipet dhe musafiret shprehen mirenjohje dhe falnderime per kete organizim.

Me 16 prill organizuam Turnirin memorial "SERVET SHALA" ne volejboll me rastin e 10 vjetorit te renjes se Tij e organizuam ne kuader te Betejes se Zhegocit me moton "Epopeja e Zhegocit 10 vjet pas"me klubin e volejbollit Bresalci ku ne kete turnir muaren pjes 2 ekipe. Nje nga,Lipjani dhe Bresalci. Triunfoi KV Lipiani nga Lipiani. U ndajten shperblime dhe mirenjohje per pjesmares. Pata nji takim me Drejtorin Fatmir Kabashi ku u pranue projekti per meremetimin e palestres sportive " Bashkim Selishta" me vlere rreth 50000 E rregullimi I Pregatitoreve nyjeve sanitare Koridorit dhomen e boksit punimet fillojne se shpejti gjate ketije sezoni veror .Ne kete muaj ju kame afruar te gjitha shenimet per sportin dhe infrastrukturen sportive te Gjilanit Entit Statistikor te Kosoves. . U organizuan disa manifestime sportive( turnire) per :” Ditet e AGIMIT” me organizatoret ne Zhegerne daten 1 2 3 maj. Me 5 Maj KK "Drita" nga Gjilani pati nji ftese nga Kampionati IMAF European Ne Cottbus te Gjermanise per daten 8,9 ,10 maj KK "Drita" I beri te gjitha pergatitjet per te udhetuar ku pati perkrahje nga Kryetari ne mjete ne vlere prej 8000 E si dhe nga Ministria e sportit ne prishtine me vlere prej 13000 E te premtuara "Drita" e ka prezentue

denjesisht Kosoven duke I marre mbi 34 Medale te arta te argjenta dhe te bronzeta nga Ky Kampionat dhe ju uroj suksese edhe ne te ardhemen. Me daten 25 05 2010 pata një takim ne Departamentin e sportit ne Prishtine me z Fatmir Kabashi Drejtor ku me njoftoj per realizimin e projektit qe e bene meremetimin e Palestres me njoftoj se komisionet jane tu punue ne fazen perfundimtare te ofertave dhe se shpejti do te dihet Pune kryesi per te filluar meremetimi gjate ketij pushimi veror. Gjate muajit qershor isha ne prishtine ku ZV.Drejtorit Z. Fatmir Kabashit I dorezova Shkresen ku nga Komuna u percaktue mbikqyrese e punimeve Znj. Drite Bajrami . e ndihmuar nga Drejtori Z Behari punimet kane vazhduar pune kryese eshte firma “Mont Commerce” nga Gjakova ku Krenar Vesvesja eshte udheheqes I punimeve prane firmes ndersa Xhavit Bingjiu inzhinjer prane kesaj firme. Me 04.07 u mbajt edhe një gare ne strite boll nen Patronatin e Kryetarit te Komunes ishte një manifestim madheshtor dhe i organizuar mire, me daten 05.07 deri me 09.07 u mbajt kampi veror ne basketboll I udhequr nga trajner Amerikan ku ndihmuar ne aspektin profesional shkollen e basketbollit “Drita” si dhe u mbajten 2 dite seminare me trajner ne ngritjen ne aspektin profesional.Gjate ketije muaji pata një ftese nga Fedrata e Volejbollit te Frances per FVK neper mes meje dhe se shpejti FFVB do ta njej FVK dhe se një delegacion shume shpejt do te udheton per Paris. Në stadiumin e qytetit ka investime ne infrastruktur sportive ku eshte renovuar fusha e stadiumit si dhe zhveshtoret etj.Klubet sportive te futbollit nw bashkpunim me DRKS kanë arritur marrveshje për ndriqimin e stadiumit per arsyse qe te hynë në funksion stadiumi edhe gjatë orëve te mbrëmjes sepse gjatë dites eshte shum i ngarkuar.

### **Spektori i bibliotekarisë**

Duke u bazuar në raportet që i kemi në dispozicion nga të gjithë sektoret e bibliotekës si dhe nga biblioteka degë,pasqyrojmë punën gjashtëmujore dhe ate:  
Biblioteka publike “F.S.Noli”gjatë këtij gjashtëmujori ka bër përpjekje drejtë realizimit të planit të punës-gjegjesisht për periudhën kohore Janar-Qershor.

Përveq punëve të përditshme apo të rëndomta në huazimin dhe kthimin e fondeve librare,paisjen e bibliotekës me tituj të rinj,punëtorët e kësaj biblioteke kanë bër përpjekje drejtë pasurimit të formave të ndryshme të bashkëpunimit me qytetar,institucione dhe biblioteka në nivel komunal e më gjerë me të vetmin qëllim që libri të jetë sa më afër lexuesit.

Për ruajtjen e fondeve librare si dhe objektit të bibliotekës e po ashtu edhe për kujdesin ndaj ambientit ku vepron biblioteka janë angazhuar të gjithë punëtorët.

Kemi mbledhur raporte edhe nga bibliotekat degë si dhe nga bibliotekat shkollore e po ashtu edhe nga bibliotekat e institucioneve tjera.Këto raporte janë analizuar me kujdes e poashtu kemi bër edhe vërejtje aty ku ka qenë e nevojshme.Është përgatitur raporti vjetor i punës për vitin 2009 i cili është dërguar në MKRS dhe në BKUK-Prishtinë.

Bibliotekën tonë e kanë vizituar grupmosha të ndryshme që nga parashkollorët e gjerë tek shfrytëzuesit më të moshuar-pensionistët.Kemi pasur nga kuadri i bibliotekës edhe vizita në bibliotekat tjera të regjionit.

Librat e përpunuara janë dorëzuar në të gjithë sektoret e bibliotekës e poashtu edhe në bibliotekat degë.

Kemi bër rexhistrimin e mjeteve themelore si dhe inventarin e imtë të bibliotekës.

Me punë vullnetare është mirëmbajtur gjendja stabile e rrymës,e ujit dhe janë bër intervenime në sanimin e avarive teknike të vogla dhe ate me mjete vetanake.

Punën e bibliotekës e kanë përcjellur në vazhdimësi mediat e shkruara si dhe ato elektronike.

Me qëllim të nxitjes për të lexuar sa më tepër kemi zgjedhur Lexuesit më të dalluar në të gjithë sektoret e bibliotekës e poashtu sipas propozimeve të librarëve komisioni i caktuar ka zgjedhur Librat më të lexuara për vitin 2009.

Vlenë të përmendet përpjekja për rihapjen e bibliotekës në fshatin Pogragjë ku është bërë praninë-dorëzimi i bibliotekës në objektin e ri.

Me kujdes dhe vëmendje të duhur është bërë zgjedhje e veprave, shkrimeve nga lëmi e zhanreve të ndryshme për pasurimin dhe ruajtjen e tyre në Sektorin e krijesëve të Vendëlindjes.

Në “vitrinë e librit të ri” janë ekspozuar botimet-titujt më të ri.

Sa i përket mbajtjes së shënimeve statistikore të bibliotekës mund të themi se puna është kryer ashtu siç duhet.

Disa nga librarët e kësaj biblioteke kanë marrë pjesë në përrurimin e Ditës së parë të “Java e bibliotekës” e cila është organizuar edhe këtë vit.

Disa nga punëtorët e bibliotekës sonë vizituan Panairin e Librit “Prishtina 2010” të organizuar në Prishtinë ku është bërë edhe furnizimi i bibliotekës me tituj të rinj.

Me datë 26 Korrik u marrë vendim që të zgjatet orari i punës së bibliotekës duke punuar gjërë në ora 21.00, ndërsa të shtunën gjërë në ora 15.00.

Me datë 13 Janar 2010 është përgatitur Projekt-propozimi për Panairin tradicional të librit “Gjilani 2010” i cili është dorëzuar me 17 Gusht 2010 në Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Gjilan.

Biblioteka gjithnjë ballafaqohet me mungesë lokale dhe nuk i përmbush kërkesat e antarëve të bibliotekës.

Gjatë kësaj kohe në bibliotekë kanë hyrë gjithësejt 2283 ekzemplarë me 890 tituj, prej tyre 107 ekzemplarë me 61 tituj janë të blera kurse dhuratë janë 2176 ekzemplarë me 829 tituj. Prej tyre 426 ekzemplarë janë për fëmijë dhe 1857 ekzemplarë janë për të rritur. Në gjuhën shqipe janë 1210 ekz., në gjuhë angleze 247 ekz., në gjuhë serbe 74 ekz. dhe në gjuhë tjera 752 ekz.. Janë përpunuar 2223 ekz.. Prej tyre 1046 ekz. janë përpunuar për fshatra. Janë bërë 45 katalogje.

Është bërë praninë i 1010 gazetave ditore si dhe i 43 revistave.

Është bërë huazimi 14469 gazetave si dhe 196 revistave.

Shërbime në sallë leximi dhe lexuesë në sallë kemi pasur 17626.

Numri i antarëve të regjistruar për gjashtë muaj vetëm në qendër arrin 1769 anëtarë të cilët kanë huazuar 12981 libra.

Janë dhënë udhëzime edhe librarëve të rinj si atijë në Bibliotekën ligjore në kuadër të zyrës ligjore në KK Gjilan.

Janë dërguar raporte statistikore në Entin e Statistikës në Gjilan dhe në BKUK.

Me 23/04/2010 është shënuar Manifestimi “Dita ndërkombëtare e librit” e përcjellur me ekspozitën e librit francez ndërsa në Karvani i shkrimtarëve për fëmijë lexuan nxënësit e shk. fill. “M. Zajmi” Gjilan si dhe ata të gjimnazit “Z. Hajdini” Gjilan. Me këtë rast të pranishmëve u prezantuan shkrimtarët Sabit Rustemi, Tahir Arifi, Hysen Këçiku, Albina Aliu, Demir Behluli, Beqir Buzuku dhe Mehmetali Rexhepi. Recituan dhe këduan edhe fëmijët e qerdhes “Ardhmëria I” Gjilan.

Kemi pasur bashkëpunim edhe me bibliotekat komunale si me Viti, Artanë dhe Dardanë.

Në raport jemi të vetëdijshëm se nuk janë përfshirë të gjitha veprimtaritë në detaje me kusht që ato do të prezantohen në raportin nëntë mujor.

**-Bibliotekat publike në fshatra** kanë qenë të vizituara rregullisht nga ana e koordinatorit. Poashtu edhe nga bibliotekat janë pranuar rregullisht raportet e punës. Nga raportet është konstatuar se në biblioteka mungon literatura e nevojshme, andaj për periudhën tjetër pritet zgjidhja e kësaj problematike, pasi që një Projekt për pasurimin e koleksioneve të bibliotekave, është aprovuar nga KK i Gjilanit, gjegjësisht nga kryetari i komunës, z. Qemajl Mustafa.

Në fshatin Pogragjë janë kryer shumë punë rreth funksionalizimit të bibliotekës: është siguruar lokali (objekti i ri), është përzgjedhur punëtori, është kryer pranim-dorëzimi nga komisioni etj. Mbetet vetëm implementimi dhe fillimi i punës gjë e cila do të bëhet së shpejti.

Në vijim do të paraqesim të dhënat për numrin e lexuesve dhe numrin e librave të lexuara, të siguruara nga punëtorët e këtyre bibliotekave, për periudhën janar -qershor 2010:

<b>Vendi</b>	<b>Numri i anëtarëve (lexuesve)</b>	<b>Numri i librave të lexuar</b>	<b>Numri i gazetave dhe revistave të lexuara</b>
Bresalc	254	1930	
Zhegër	500	3724	
Malishevë	427	2837	
Përlepticë	322	1951	
Llashticë	194	1334	124
Mireshe	273	2616	
Budrika e Ulët	90	434	
Pasjan	47	245	
Koretishtë			
Partesh	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	
Gjithsej:	2107	15071	124

Gjatë periudhës gjashtëmujore, bibliotekat publike janë pasuruar me numër të caktuar të fondit librar, i cili kryesisht është siguruar nga donatorët.

Do theksuar rastin e bibliotekës në fshatin Shillovë, fondi i së cilës është pasuruar nga fondi I Bibliotekës së Qytetit “Latif Berisha” nga Mitrovica, nga Biblioteka e Qytetit “Hivzi Sulejmani” e Prishtinësi dhe nga Biblioteka “Fan S. Noli” e Gjilanit.



Në vijim do të paraqesim në mënyrë tabelare pasurimin e fondit librar për secilën bibliotekë veç e veç:

<b>Vendi</b>	<b>Sasia e libravë me të cilat janë pasuruar bibliotekat</b>
Bresalc	129
Zhegër	199
Malishevë	110
Përlepticë	186
Llashticë	171
Mireshe	127
Budrika e Ulët	-
Pogragjë	126
Pasjan	351
Koretishtë	-
Partesh	-
Shillovë	3200
<b>Gjithsej:</b>	<b>4599</b>

Drejtori për Rini, Kulturë e Sport

/ Selver Xhelili /